

DITARI MUJOR

Qershor, 2024/ Vol. 004


Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me Dhomën Shqiptaro-Turke të Tregtisë dhe Industrisë (ATTSO) organizuan forumin “Global Energy Insights: Albania Investments & Market Trends”

Drejtori Ekzekutiv i AIDA, znj. Laura Saro dhe z. Bilal Kara, Kryetar i Bordit të ATTSO, përshëndetën eventin dhe Znj. Saro mbajti dhe një prezantim mbi mundësitë e investimit në Shqipëri. Paneli u pasua nga prezantimet e të ftuarve. Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional me dhomat e tregtisë, AIDA nënshkroi Memorandumin e Bashkëpunimit me ATTSO, si një hap më tej drejt fuqizimit të raporteve ekonomike dypalëshe.



Ftesë për pjesëmarrje në panairin Food Ingredients-North America, Supply Side West

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me ITC Albania (Internacional Trade Centre) dhe SIPPO Albania (Swiss Import Promotion Programme), po planifikojnë pjesëmarrjen me stand të Shqipërisë në këtë panair, i cili do të zhvillohet në Las Vegas, USA, shpalli thirrjen për aplikim për kompanitë që duan të përfitojnë nga kjo mundësi.



Thirrje për Ofrimin e shërbimit të mentorimit për aksesin në financë dhe Simulim në paraqitjen e ideve të biznesit

AIDA, në kuadër të zbatimit të projektit “Aftësi për Punësim të Qendrueshëm dhe Rritje Ekonomike Gjithëpërfshirëse të Rajonit Ndërkufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi – Aftësi për Punësim Shqiptarë – Mal i Zi”, financuar nga BE, shpalli thirrjen për aplikim për të interesuarit.



Turizimi vijon rritjen...

Vetëm gjatë muajit Maj 2024, kanë hyrë në territorin shqiptar 974 mijë vizitorë të huaj, duke u rritur me 38 %, krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë. Ky muaj ka arritur numrin më të lartë të hyrjeve të shtetasve të huaj, deri më tani për vitin 2024, ku treguesi ka ndjekur një progres të vazhdueshëm përgjatë muajve. Numri i vizitorëve të huaj ka arritur shifrën e 3.3 milion për periudhën janar-maj 2024, duke u rritur me 38% krahasuar me një vit më parë, ku për periudhën janar-maj 2023 ishte 2.4 milion.



Eksportet vijojnë ecurinë pozitive në muajin Maj 2024

Eksportet e mallrave arritën vlerën 35 mld lekë në Maj 2024, duke u rritur me 0,5 %, në krahasim me një muaj më parë dhe duke shënuar vlerën 165 mld lekë në këtë pesëmuajor të vitit. Në këtë muaj, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 68,2 % të eksporteve gjithsej.



AIDA në fushatën outreach me fokus sektorit e turizmit në Spanjë përgjatë datave 18-20 Qershor 2024

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), me mbështetjen e Regional Cooperation Council (RCC) dhe World Bank Group (WBG) zhvilloi një fushatë outreach me fokus sektorit e turizmit në Spanjë përgjatë datave 18-20 Qershor 2024.

Në kuadër të tërheqjes së brandeve elitare europiane në tregun vendas, AIDA zhvilloi takime fizike me disa prej grupeve hoteliere më në zë spanjolle, duke përfshirë Barcelo Group, Catalonia Hotels dhe Eurostar Hotels by Grupo Hotusa për të prezantuar ofertën e qeverisë shqiptare, incentivat fiskale të sektorit të turizmit, avantazhet konkurruese të Shqipërisë etj.

Gjatë takimeve u konstatua një interes i lartë për t'u bërë pjesë e tregut shqiptar, dhe se vemendja e grupeve hoteliere më të mëdha spanjolle është të zhvillojnë struktura elitare në bregdetin shqiptar, por pa përjashtuar dhe vendosjen në qytetet më të mëdha në vend.

Krahas bukurive natyrore dhe incentivave konkurruese fiskale, grupet hoteliere vlerësuan dhe përmirësimin e infrastrukturës vendase si dhe ndërlidhjet frekvente ajrore mes dy vendeve si një vlerë të shtuar në ofertën e Shqipërisë për të investuar në turizëm.

Grupet hoteliere vlerësuan gjithashtu nismën dhe punën e AIDA-s, e cila tanimë do të jetë një bashkëudhëtar në rrugëtimin e tyre drejt Shqipërisë. Përfaqësues të grupeve hoteliere do të vizitojnë personalisht Shqipërinë përgjatë periudhës Korrik- Shtator 2024, ku do të asistohen dhe nga AIDA.

Në përfundim të këtyre takimeve, AIDA zhvilloi gjithashtu një takim me Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Madrid dhe me Dhomën e Ekonomisë Shqiptëri - Spanjë ku krahas diskutimeve mbi interesin e shtuar drejt Shqipërisë si një destinacion për të investuar në sektorin e turizmit dhe jo vetëm, u vlerësua dhe nevoja për një koordinim të shtuar dhe sa më eficient të aktorëve publik dhe privatë në funksion të realizimit të objektivit të përbashkët të fuqizimit të ekonomisë shqiptare.



AIDA pjesë e trajnimit mbi investimet në Torino

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve mori pjesë në trajnimin "Investment facilitation, decent work and sustainable development", në Torino, nga 11 deri më 14 qershor 2024.

Ky trajnim u organizua nga Unioni për Mesdheun (UfM), i mbështetur nga GIZ dhe në partneritet me Qendrën Ndërkombëtare të Trajnimit të Organizatës

Ndërkombëtare të Punës (ITCILO) dhe mbledhi së bashku përfaqësues nga Agjencitë për Promovimin e Investimeve (IPA), ministritë përkatëse dhe organizatat për mbështetjen e biznesit nga i gjithë rajoni.

Duke përfutur nga sugjerimet dhe rekomandimet e paçmuara nga ky trajnim, AIDA është e përkushtuar të zbatojë nisma të mëtejshme që promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm si edhe të krijojë mundësi të vlefshme për bashkëpunim me agjencitë homologe në rajonin e Mesdheut.



AIDA pjesë e Vizitës Studimore për Promovimin e Investimeve, 24-28 Qershor 2024, Poloni

Ky aktivitet u organizua dhe financua nga Projekti i USAID-it për Zhvillimin Ekonomik, Qeverisjen dhe Rritjen e Ndërmarrjeve (EDGE) dhe bëri bashkë Agjencitë e Promovimit të Investimeve nga Shqipëria, Armenia, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Serbia, Uzbekistani, Kirgistani dhe Kazakistani. Qëllimi i vizitës ishte njohja me praktikën më të mirë në krijimin dhe zbatimin e një mjedisi të favorshëm për investimet e huaja direkte, ku pjesëmarrësit u njohën nga afër me rastin e Polonisë, si një model suksesi në tërheqjen e IHD-ve.

Përgjatë ditëve të vizitës, agjencitë u pritën nga Invest in Pomerania dhe Polish Investment and Trade Agency (PAIH), të cilët ndanë me të pranishmit arsyet e suksesit dhe praktikën e ndjekura nga secila agjenci në tërheqjen e investimeve në rajonin e Pomeranias dhe në shtetin e Polonisë.

Gjithashtu, u vizituan nga afër Zonat e Veçanta Ekonomike dhe Parqet Teknologjike, si dhe kompania Northvolt. Pjesë e rëndësishme e kësaj vizite, ishin dhe prezantimet e rasteve studimore nga vetë drejtuesit e lartë të kompanive që kanë vendosur të operojnë në Poloni.

Agjencitë homologe ndanë dëshirën për të zhvilluar bashkëpunime të mëtejshme me AIDA-n dhe kompanitë shfaqën interesin për ta konsideruar Shqipërinë si një destinacion investimi. Përfaqësuesit e AIDA-s shprehën gatishmërinë për të asistuar kompanitë dhe për të bashkëpunuar me homologët.



AIDA pjesë e SIPPO Import Forum

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në përmbushje të funksionit të saj si institucion kyç në nxitjen e zhvillimit ekonomik si dhe promovimin e eksporteve, mori pjesë në SIPPO Annual Global Meeting 2024 "SIPPO Import Forum 2024: Exchange between BSOs and Swiss importer networks" në Lausanne, Zvicër, datë 11-13 Qershor, 2024.

SIPPO Import Forum, në një format të ri, lehtëson shkëmbimin midis BSO-ve (business support organizations) në vendet SIPPO dhe rrjeteve zvicerane të importuesve dhe organizatave të promovimit të importit për çështjet që lidhen me tregtinë. Qëllimi i tij është të bashkojë BSO-të nga vendet SIPPO me këto rrjete importuese aktive në sektorët mbulues të SIPPO, menaxherë të ndryshëm, si dhe ekspertë të sektorit. Tema kryesore e këtij viti ishte "Për rrjetet tregtare që funksionojnë: Identifikimi dhe adresimi i rregulloreve që ndikojnë në tregti".

Programi përfshiu tryeza të rumbullakëta mes BSO-ve, mbledhjen e Bordit Këshillimor të SIPPO-së dhe një Forum në stilin e seminarit me një fjalim kryesor në plenare, i ndjekur nga sesioni paralel për temat e sugjeruara nga Ekipet e vendit të SIPPO-së në konsultim me BSO-të.



Vizita në kompani në kuadër të pjesëmarrjes në panairin “IFEMA MOMAD Fashion Madrid” Shtator 2024

AIDA po mbështet aktivisht eksportuesit shqiptarë për të eksportuar në tregjet e BE-së. Përgatitja e mirë e eksportuesve shqiptarë është shumë e rëndësishme për projektin tonë të ri, IFEMA MOMAD Fashion Madrid, nga data 13-15 Shtator,

Qëllimi ynë është të promovojmë sektorin e prodhimit të modës dhe të ndihmojmë kompanitë të aksesojnë tregje të reja, të mësojnë për tendencat e reja dhe të zhvillojnë marrëdhënie me organizatat partnere të biznesit (BSO) në tregun evropian për të mundësuar ngjarje sektoriale të përbashkëta dhe aktivitete promovionale.

Në datat 23-25 maj, AIDA-s dhe SIPPO-s së bashku me ekspertë, vizituan kompanitë bashkë-eksportuese “EFA Solution”, “Krienko - Bluesky shpk”, “Tailor Fashion” dhe “A&M Fashion”. Synimi ynë ishte të kuptonim nevojat e tyre të biznesit dhe të ofronim njohuri mbi tendencat e modës dhe qëndrueshmërisë, materialet promovionale dhe ide për zhvillimin e biznesit përmes takimeve B2B.

Bashkëpunimi i AIDA-s me SIPPO dhe PROEKSPORT si ekip është thelbësor për të ofruar mbështetje të rëndësishme për kompanitë eksportuese në kapjen e mundësive të tregut gjatë këtyre kohërave sfiduese.

Shqipëria ka një potencial të madh për outsourcing dhe investime në sektorin e prodhimit të veshjeve. Ajo ofron energji 100% të rinovueshme, ekspertizë të nivelit të mesëm dhe të lartë, dhe afërsi me tregjet e BE-së. AIDA inkurajon kompanitë e tjera të na bashkohen për të shfrytëzuar potencialin “Made in Albania” për sukses ndërkombëtar.

